



V E N D I M

Nr.690, datë 22. 11. 2017

P Ë R

KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMITETIT SHTETËROR PËR DIASPORËN

Në mbështetje të neneve 95, pika 2, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ngritjen e Komitetit Shtetëror për Diasporën, këtu e në vijim Komiteti, si organ konsultativ i Këshillit të Ministrave për bashkërendimin e politikave e të veprimtarive shtetërore në fushën e diasporës.

2. Komiteti kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje të tij këta anëtarë:

- a) Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- b) Ministrin e Brendshëm;
- c) Ministrin e Financave dhe Ekonomisë;
- ç) Ministrin e Drejtësisë;
- d) Ministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- dh) Ministrin e Kulturës;
- e) Ministrin e Mjedisit dhe Turizmit;
- ë) Ministrin e Shtetit për Diasporën;
- f) Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë;
- g) Kryetarin e Akademisë së Shkencave;
- gj) Drejtorin e INSTAT-it.

3. Fusha e veprimtarisë së Komitetit përfshin:

- a) përgatitjen e linjave orientuese për hartimin e politikave të reja aktive dhe përcaktimin e prioritetëve strategjike në fushën e diasporës;
- b) propozimin e mekanizmave ligjorë dhe institucionalë për çështje që lidhen me përmirësimin e pozitës së anëtarëve të diasporës dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre në vendet ku jetojnë;



- c) nxitjen dhe zhvillimin e dialogut për zbatimin e strategjisë, politikave dhe legjisllacionit në fushën e zhvillimit të komuniteteve të diasporës;
- ç) koordinimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën;
- d) mbështetjen dhe monitorimin e veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare për Diasporën.

4. Komiteti mbliidhet jo më pak se një herë në tre muaj dhe sa herë është e nevojshme, me kërkesë të Kryeministrit.

5. Në mbledhjet e Komitetit mund të ftohen të marrin pjesë dhe përfaqësues të grupeve parlamentare, të organeve të qeverisjes qendrore e vendore apo të institucioneve të tjera, pjesëmarrja e të cilëve çmohet e vlefshme për përmbushjen e misionit.

6. Veprimtaria e Komitetit mbështetet nga sekretariati teknik. Përbërja dhe detyrat e sekretariatit teknik përcaktohen me urdhër të Kryeministrit.

7. Urdhri nr.115, datë 11.5.2006, i Kryeministrit, "Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Ndërmintor të Migracionit", shfuqizohet.

8. Ngarkohen anëtarët e Komitetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

**MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN**

PANDELI MAJKO